



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

PROJEKTLIGJI PËR AVOKATIN E POPULLIT

DRAFT LAW ON OMBUDSPERSON

NACRT ZAKON O NARODNOM ADVOKATU

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR AVOKATIN E POPULLIT</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1.Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: autoritetet publike), si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.</p>	<p>The Assembly of Republic of Kosovo,</p> <p>In support of Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>THE LAW ON OMBUDSPERSON</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>1.This Law aims to establish legal mechanism for protection, supervision and promotion of fundamental rights and freedoms of natural and legal persons from illegal actions or failures to act and improper actions of public authorities, institutions and persons or other bodies and organizations exercising public authorizations in the Republic of Kosovo (further in the text: public authorities), and the establishment of the National Mechanism for the Prevention of torture and other cruel, inhuman and degrading punishments.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O NARODNOM ADVOKATU</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Cilj</p> <p>1.Ovaj Zakon ima za cilj stvaranje zakonskog mehanizma za zaštitu, nadgledanje i promovisanje prava i osnovnih sloboda fizičkih i pravnih lica od nezakonitih i nepravilnih radnji ili neradnji javnih autoriteta, institucija i lica ili drugih autoriteta koje vrše javnu vlast u Republici Kosovo (u daljem tekstu; javnih autoriteti), kao i stvaranje Nacionalnog Mehanizma za sprečavanje torture i drugih okrutnih kazni, nečovečno i ponižavajuće.</p>
---	---	---

<p>2. Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi.</p>	<p>2. The Ombudsperson is a mechanism of equality for promoting, monitoring and supporting equal treatment without discrimination on grounds protected by the Law on Gender Equality and the Anti-Discrimination Law.</p>	<p>2. Narodni Advokat je mehanizam za promociju jednakosti, praćenje i podršku jednakog tretmana bez diskriminacije prema osnovama zaštićenim Zakonom o ravnopravnosti polova i Zakonom o zaštiti protiv diskriminacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p>
<p>Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar procedurat për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyrën e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.</p>	<p>This Law regulates the organization and functioning of the Ombudsperson Institution, determining procedures for appointment and dismissal, powers and manner of work of the Institution of Ombudsperson, as well as it regulates the procedures for submission of complaints and their investigation.</p>	<p>Ovim zakonom se uređjuje organizovanje i funkcionisanje Institucije Narodnog Advokata, utvrđivši postupke o imenovanju i razrešenju, nadležnosti i način rada Institucije Narodnog advokata kao i reguliše postupke za podnošenje žalbi i njihovo ispitivanje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Basic Principles of Ombudsperson’s activity</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Osnovna načela delatnosti Narodnog Advokata</p>
<p>1. Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.</p> <p>2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga</p>	<p>1. Ombudsperson is an independent institution that is governed by the principles of impartiality, independence, preeminence of human rights, confidentiality and professionalism.</p> <p>2. The provisions of this Law apply to protect the rights, freedoms and interests of all persons in the Republic of Kosovo and abroad from illegal actions or the</p>	<p>1. Narodni Advokat je nezavisna institucija koja se rukovodi načelom nepristrasnosti, konfidencijalnosti i profesionalizma.</p> <p>2. Odredbe ovog zakona se primenjuju u cilju zaštite prava, sloboda i interesa svih lica u Republici Kosovo i van nje, od nezakonitih radnji ili neradnji od strane</p>

<p>veprimet apo mosveprimet e paligjshme të autoriteteve publike.</p> <p>3.Institucioni i Avokatit të Popullit gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Gjuha e punës</p> <p>Gjuhë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Përbërja e Institucionit të Avokatit të Popullit</p> <p>1.Institucioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Avokati i Popullit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Një (1), por jo më shumë se pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit.</p>	<p>authorities' failure to act.</p> <p>3. The institution of the Ombudsperson enjoys organizational, administrative and financial independence in the implementation of tasks set forth by the Constitution of the Republic of Kosovo and the Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Working language</p> <p>Working Languages of the Institution of the Ombudsperson are official languages envisaged by the Constitution and Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Composition of the Ombudsperson Institution</p> <p>1.Ombudsperson Institution is composed of:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Ombudsperson;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.One (1), but no more than five (5) Deputy Ombudspersons;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Staff of the Ombudsperson Institution.</p>	<p>autoriteta.</p> <p>3.Institucija Narodnog Advokata uživa organizacionu, administrativnu i finansijsku nezavisnost za ostvarenje zadataka određene Ustavom Republike Kosova i zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Jezik rada</p> <p>Jezik rada Institucije Narodnog Advokata su službeni jezici predviđeni Ustavom i zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Sastav institucije Narodnog Advokata</p> <p>1.Institucija Narodnog Advokata sastoji se od:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Narodnog Advokata;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Jednog (1), ali ne više od pet (5) zamenika Narodnog Advokata;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Osoblja Institucije Narodnog Advokata.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 6 Kushtet për zgjedhjen e A vokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj</p> <p>1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj zgjedhen personat që i plotësojnë këto kushte:</p> <p>1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë arsimim të lartë universitar;</p> <p>1.3. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;</p> <p>1.4. të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut;</p> <p>1.5. të mos ushtrojë funksion në parti politike, të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtar/e i/e kabinetit qeveritar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Conditions for election of the Ombudsperson and his/her deputies</p> <p>1. The Ombudsperson and his/her deputies are elected persons who meet the following criteria:</p> <p>1.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. have higher university education;</p> <p>1.3. have character, honesty and high moral;</p> <p>1.4. be experienced and have distinguished knowledge in the field of human rights;</p> <p>1.5. not exercise any function in any political party, not be a assembly member in the legislature of the Republic of Kosovo Assembly that elects him/her, or as a government cabinet member.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Uslovi za izbor Narodnog advokata i njegovih/njenih zamenika</p> <p>1. Za Narodnog Advokata i njegove zamenike, biraju se lica koja ispunjavaju sledeće uslove:</p> <p>1.1. da je državljanin Republike Kosovo;</p> <p>1.2. da ima visoko univerzitetsko obrazovanje;</p> <p>1.3. da ima karakter, čestitost i visoki moral,</p> <p>1.4. da ima iskustvo i široka saznanja u oblasti ljudskih prava,</p> <p>1.5. da ne obavlja funkciju u političku partiju, da ne bude poslanik legislature Skupštine Republike Kosovo koja ga bira ili član vladinog kabineta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Papajtueshmëria</p> <p>1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Incompatibility</p> <p>1. Ombudsperson and his/her deputies</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Nekompatibilnost</p> <p>1. Narodni Advokat i njegovi/njeni zamenici</p>

<p>tij/saj nuk duhet të jenë anëtarë të asnjë partie politike e as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale.</p> <p>2. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.</p> <p>3. Përveç ndalesave të përcaktuara në nënparagrafin 1.5 të nenit 6 të këtij ligji dhe paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>4. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Avokati i Popullit mund të ushtrojë funksione tjera me autorizim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>should not be members of any political party nor to exercise political, state or private professional activity.</p> <p>2. Ombudsperson and his/her deputies do not participate in the management bodies of civil, economic and trade organizations.</p> <p>3. Apart from restrictions set forth in subparagraph 1.5 Article 6 of this Law and paragraph 1 and 2 of this Article, the Ombudsperson and his/her Deputies have no right to exercise any other public or professional duty for which they are paid, except teaching at the institutions of higher education.</p> <p>4. The Ombudsperson and his/her deputies may be involved in science, cultural, academic activities and other activities which are not in contrary to their functions and the legislation in force.</p> <p>5. The Ombudsperson can exercise other functions with a granted authorization from the Assembly of the Republic of Kosovo.</p>	<p>ne mogu da budu članovi neke političke partije a niti da vrše političku, državnu i privatno profesionalnu delatnost.</p> <p>2. Narodni Advokat i njegovi zamenici ne učestvuju u upravnim organizmima civilnih, ekonomskih i trgovačkih organizacija.</p> <p>3. Osim zabrana odredjenih u podstavu 1.5 člana 6 i stavu 1 i 2 ovog člana, Narodni Advokat i njegovi zamenici nemaju pravo da vrše neku drugu javnu ili profesionalnu dužnost, za koju primaju platu, osim predavača u institucijama visokog obrazovanja;</p> <p>4. Narodni Advokat i njegovi/njeni zamenici mogu se baviti naučnom, kulturnom, akademskom i drugim delatnostima, koje nisu u suprotnosti sa njihovom funkcijom i sa zakonodavstvom na snazi.</p> <p>5. Narodni Advokat može obavljati i druge funkcije na osnovu ovlašćenja Skupštine Republike Kosovo.</p>
--	---	---

KAPITULLI II	CHAPTER II	POGLAVLJE II
<p>PROPOZIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE ZËVENDËSVE TË TIJ/SAJ</p>	<p>PROPOSAL, ELECTION AND DISMISSAL OF THE OMBUDSPERSON AND HIS/HER DEPUTIES</p>	<p>PREDLOG, IZBOR I RAZREŠENJE NARODNOG ADVOKATA I NJEGOVIH/NJENIH ZAMENIKA</p>
<p>Neni 8 Procedura e propozimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit</p>	<p>Article 8 Proposal Procedures for Ombudsperson election</p>	<p>Član 8 Postupak predloga za izbor Narodnog Advokata</p>
<p>1.Procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të tij.</p>	<p>1.The procedure for electing the Ombudsperson starts six (6) months before the expiration of his/her mandate.</p>	<p>1. Postupak za izbor Narodnog Advokata počinje šest (6) meseci pre isteka njegovog mandata.</p>
<p>2.Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohe në rast dorëheqjeje, shkarkimi apo vdekjes së Avokatit të Popullit, procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit fillon brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e lirimit të postit.</p>	<p>2. Notwithstanding from paragraph 1 of this Article, when the mandate ends prematurely in case of resignation, dismissal or death of the Ombudsperson, procedure for Ombudsperson election starts within thirty (30) days from the date of post vacated.</p>	<p>2.Izuzetno iz stava 1. ovog člana, kada se mandat završava pre vremena, u slučaju ostavke, razrešenja ili smrti Narodnog advokata, postupak za izbor Narodnog advokata počinje u toku trideset (30) dana od dana oslobađanja položaja.</p>
<p>3.Kuvendi i Republikës së Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në media të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>3.The Assembly of the Republic Kosovo publishes the competition for election of Ombudsperson, in written and electronic media.</p>	<p>3.Skupština Republike Kosova raspisuje konkurs za izbor Narodnog advokata u pisanim i elektronskim medijima.</p>
<p>4.Në konkurs caktohen kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se</p>	<p>4.Terms and conditions for election of Ombudsperson are foreseen by the Constitution and this Law are determined by the completion. The time period for submission of candidates' proposals cannot</p>	<p>4.U konkursu određuju se uslovi za izbor Narodnog advokata, predviđeni Ustavom I ovim zakonom.Rok trajanja konkursa ne može biti kraći od petnajest (15) dana, niti duži od dvadeset (20) dana.</p>

<p>pesëmbëdhjetë (15) e as më i gjatë se njëzetë (20) ditë.</p> <p>5.Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, Paneli përgjdhës (në tekstin e mëtejme: Paneli), i caktuar nga Komisioni kompetent për të drejtat e njeriut, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedh poshtë kandidaturat që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs.</p> <p>6.Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për Avokat të Popullit, duhet të inkurajohet përfaqësimi etnik dhe gjinor.</p> <p>7.Paneli zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Avokat të Popullit.</p> <p>8.Lista e ngushtë përmban tre (3) kandidatë dhe i dorëzohet Komisionit nga Paneli.</p>	<p>be shorter than fifteen (15) nor longer than twenty (20) days.</p> <p>5.After expiration of time period foreseen in paragraph 4 of this Article, the selection Panel (hereinafter: the Panel) appointed by the competent Commission for Human Rights, the Assembly of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Commission), within the period of fifteen (15) days, assesses whether the candidates meet the requirements envisaged by the Constitution and the Law to be elected Ombudsperson, and rejects nominees who do not meet these conditions.</p> <p>6.During the election procedure of candidates for Ombudsperson, ethnic and gender representation must be encouraged.</p> <p>7. The Panel conducts interview with each candidate who meets the conditions to be elected for Ombudsperson and based on the data presented and the interview results, prepares the short list of candidates qualified for Ombudsperson.</p> <p>8.The short list comprises of three (3) candidates, and the Panel submits it to the Commission.</p>	<p>5. Nakon isteka roka predviđenog u stavu 4 ovog člana, izborni Panel (u daljem tekstu: Panel), imenovan od strane nadležne Komisije za ljudska prava Skupštine Kosova (u daljem tekstu: Komisija) u roku od petnaest (15) dana, ocenjuje da li kandidati ispunjavaju uslove da budu izabrani za ombudsman, propisano Ustavom i zakonom, i odbacuje kandidate koji ne ispunjavaju uslove utvrđene konkursom.</p> <p>6.Tokom postupka izbora kandidata za Narodnog advokata, treba da se podstiče etničko i polno zastupanje.</p> <p>7.Panel obavlja (razvija) intervju sa svakim kandidatom koji ispunjava uslove za bude izabran za Narodnog Advokata, i na osnovu podnetih podataka i rezultata intervjuisanja, priprema užu listu kvalifikovanih kandidata za Narodnog Advokata.</p> <p>8.Uža lista sadrži tri (3) kandidata, i dostavlja se Komisiji od strane Panela.</p>
--	--	--

<p>9. Propozimin e Avokatit të Popullit e bënë Komisioni.</p> <p>10. Komisioni, bashkëngjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit.</p> <p>11. Propozimi i Komisioni përmban arsyetimin përse Paneli ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.</p> <p>12. Procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit të Avokatit të Popullit, rregullohet me Rregullore të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>9. Proposal for Ombudsperson is made by the Commission.</p> <p>10. The Commission submits to the Assembly of the Republic of Kosovo the short list, together with the list of all candidates who meet the requirements to be elected for Ombudsperson.</p> <p>11. The Commission's proposal contains the justification why the Panel has given priority to some of the candidates in comparison with other candidates.</p> <p>12. The procedure for election and dismissal of the Ombudsperson shall be regulated with a special Regulation of the Assembly of the Republic of Kosovo.</p>	<p>9. Predlog za ombudsman, podnese se od strane Komisije.</p> <p>10. Komisija, u prilog uže liste, Skupštini Republike Kosovo, dostavlja i listu svih kandidata koji ispunjavaju uslove za Narodnog advokata.</p> <p>11. Predlog Komisije sadrži obrazloženje zašto Panel je dao prednost nekim kandidatima u odnosu na druge kandidate.</p> <p>12. Postupak izbora i razrešenja Narodnog Advokata reguliše se posebnim Pravilnikom Skupštine Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Zgjedhja e Avokatit të Popullit</p> <p>1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p>2. Avokati i Popullit duhet të zgjedhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Election of the Ombudsperson</p> <p>1. The Ombudsperson is elected by the Assembly of the Republic of Kosovo, with a majority of votes of all its deputies for a term of five (5) years, without the right of re-election.</p> <p>2. The Ombudsperson should be elected within thirty (30) days from the day of proposal of candidates.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Izbor Narodnog Advokata</p> <p>1. Narodnog advokata bira Skupština Republike Kosova, većinom glasova svih njenih poslanika, za peto godišnji (5) mandat, bez prava reizbora.</p> <p>2. Narodni Advokat mora se izabrati u roku od trideset (30) dana od dana predlaganja kandidata.</p>

<p>3. Në rrethin parë votohet për tre (3) kandidatët e propozuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, dy (2) kandidatët që fitojnë më së shumti vota, i nënshtrohen rrethit të dytë të votimit. Nëse as në rrethin e dytë nuk zgjedhet Avokati i Popullit, kandidati me numrin më të madh të votave nga rrethi i dytë, si kandidat i vetëm i nënshtrohet rrethit të tretë të votimit.</p> <p>4. Nëse kandidatët marrim numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet derisa njëri prej kandidatëve fiton numrin më të madh të votave.</p> <p>5. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjedhet në seancën e parë, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në seancë plenare brenda tridhjetë (30) ditëve në vijim.</p> <p>6. Në seancën e ardhshme për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, Kuvendi, sipas procedurës në paragrafin 3 të këtij neni voton për kandidatët e tjerë që kanë plotësuar kushtet e konkursit, sipas radhitjes në listën hartuar pas intervistimit nga Komisioni përzgjedhës i Kuvendit, duke përjashtuar kandidatët e propozuar</p>	<p>3. In the first round three (3) proposed candidates from the respective Committee of Assembly are voted. If in the first round no candidate receives the majority of votes of all deputies, two (2) of them who have been voted highly, continue to the second round of voting. In case the Ombudsperson is not elected in the second round as well, the candidate who has collected the most number of votes in the second round, as the only candidate, becomes the subject of the a third round of voting.</p> <p>4. If candidates receive the same number of votes, the voting is repeated until one candidate receives the largest number of votes.</p> <p>5. In case the Ombudsperson is not elected in the first session, the Assembly of the Republic of Kosovo votes for the election of the Ombudsperson in the plenary session within the following thirty (30) days.</p> <p>6. In the next session for election of the Ombudsperson, the Assembly, according to the procedures in the paragraph 3 of this article votes for other candidates who meet the requirements of competition, following the order in the list compiled after the interview conducted by the appointed Commission of the Assembly, excluding</p>	<p>3. U prvom krugu glasa se za tri (3) predložena kandidata od strane odgovarajuće Komisije Skupštine. Ako u prvom krugu nijedan kandidat ne dobije većinu glasova svih narodnih poslanika, dva (2) kandidata koji dobiju najviše glasova, idu na drugi krug glasanja.. Ako ni u drugom krugu se ne izabere Narodni advokat, kandidat sa najvećim brojem glasova iz drugog kruga, kao jedini kandidat ide u trećem krugu glasanja.</p> <p>4. Ako kandidati dobijaju isti broj glasova , glasanje se ponavlja sve dok jedan kandidat ne dobije najveći broj glasova.</p> <p>5. Ukoliko se Narodni Advokat ne izabere na prvoj sednici, Skupština Republike Kosovo glasa za izbor Narodnog Advokata na plenarnoj sednici narednih trideset (30) dana.</p> <p>6. Na narednoj sednici za izbor Narodnog Advokata, Skupština, na osnovu postupka u stavu 3 ovog člana, glasa za ostale kandidate koji su ispunili uslove konkursa, prema redosledu liste sačinjene nakon intervjuisanja Komisije za izbor od strane Skupštine Kosova, izuzimajući predložene kandidate od strane odgovarajuće komisije,</p>
---	---	---

<p>nga komisioni përkatës për të cilët është votuar në seancën e parë.</p> <p>7. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet as në seancën e dytë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, Kuvendi përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të popullit</p> <p>1. Propozimi për zëvendësit e Avokatit të Popullit, bëhet nga Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Institucioni i Avokatit të Popullit.</p> <p>2. Avokati i Popullit i propozon Kuvendit listën prej një (1) kandidati për zgjedhjen e një zëvendësi.</p> <p>3. Propozimi i Avokatit të Popullit përmban arsyetimin për kandidatët e propozuar.</p> <p>4. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për zëvendësit e Avokatit të Popullit, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor. Të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të</p>	<p>proposed candidates by the respective Committee who have been voted in the first session.</p> <p>7. If the Ombudsperson is not elected in the second session within sixty (60) days as well, the Assembly shall announce a new competition for the Ombudsperson.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Procedure for election of Deputy Ombudspersons</p> <p>1. The Ombudsperson makes proposal for deputies based on an open and transparent competition, according to the vacancy announcement by the Ombudsperson Institution.</p> <p>2. The Ombudsperson proposes to the Assembly the list from one (1) candidate for election of one deputy.</p> <p>3. The Ombudsperson's proposal contains justification for the proposed candidate.</p> <p>4. During election procedure of candidates for deputy Ombudsperson, ethnic and gender representation must be ensured. At least one of the Ombudsperson's deputies ought to be a member of non-majority</p>	<p>o kojima je glasano na prvoj sednici.</p> <p>7. Ako ombudsman nije izabran ni u drugom sednicu u roku od šezdeset (60) dana, Skupština će ponovo objavljivati konkurs za Ombudsmana.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Postupak za izbor zamenika Narodnog advokata</p> <p>1. Predlog za zamekike Narodnog Advokata vrši se od strane Narodnog Advokata, na osnovu otvorene i trnsparentne konkurencije, na osnovu raspisanog konkursa od strane Institucije Narodnog Advokata.</p> <p>2. Narodni advokat predlaže Skupštini listu od jednog (1) kandidata za izbor jednog zamenika.</p> <p>3. Predlog Narodnog advokata sadrži obrazloženje o predloženim kandidatima.</p> <p>4. Tokom postupka izbora kandidata za zamenike ombudsmana, treba da se obezbedi etnička i polna zastupljenost . Najmanje jedan zamenik ombudsmana mora biti član jedne od zajednica, i suprotnog</p>
--	---	---

<p>jetë pjesëtar i njërës nga komunitetet dhe gjinisë tjetër që ndryshon nga ajo e Avokatit të Popullit.</p> <p>5.Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjedhen nga Kuvendi, me mandat tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.</p> <p>6.Paragrafi 1,2,4 të nenit 8 të këtij ligji përshtatshëmrisht aplikohen edhe për zëvendësit e Avokatit të Popullit.</p> <p>7.Avokati i Popullit me Rregullore të brendshme përcakton mënyrën e konkurimit, procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit.</p> <p>8. Avokati i Popullit, njërin nga zëvendësit e zgjedhur e cakton zëvendës kryesor të tij me rotacion për një mandat një (1) vjeçar.</p>	<p>communities in Kosovo, and from the gender that differs from that of the Ombudsperson.</p> <p>5.Deputies are elected by the Assembly, with a three (3) year mandate with possibility for re-election.</p> <p>6. Paragraph 1, 2, 4 of the Article 8 of this Law appropriately are applied for the deputy Ombudsperson as well.</p> <p>7.The Ombudsperson through internal Regulations determines the way of application, election procedure as well as proposed list with candidates' names for Ombudsperson deputies.</p> <p>8. One of the elected deputies is appointed as Principal deputy with rotation for one (1) year mandate by the Ombudsperson.</p>	<p>pola, koji se razlikuje od onog iz ombudsmana.</p> <p>5.Zamenici Narodnog Advokata biraju se od strane Skupštine, sa mandatom od tri (3) godine uz mogućnost ponovnog izbora.</p> <p>6.Stav 1,2,4 člana 8 ovog zakona, shodno se primenjuju i za zamenike Narodnog Advokata.</p> <p>7.Narodni Advokat, unutrašnjim pravilnikom utvrđuje način konkurisanja, procedure izbora i predlaganja liste sa imenima kandidata za zamenike Narodnog advokata.</p> <p>8.Narodni Advokat, jednog od izabranih zamenika određuje ga za njegovog glavnog zamenika, sa jednogodišnjim (1) mandatom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Marrja e detyrës dhe betimi</p> <p>1.Avokati i Popullit merr detyrën pasi të ketë dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Taking over the duty and oath</p> <p>1.The Ombudsperson shall take over the duty after having given the oath before members of the Assembly of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Primanje dužnosti i zakletva</p> <p>1.Ombudsman preuzme dužnost nakon polaganja zakletve pred Skupštinom Republike Kosovo.</p>

<p>2.Teksti i betimit është si në vijim: “Unë betohem dhe premtoj solemnisht se do t’i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar me Kushtetutë dhe me ligj, se do t’i mbroj dhe avancoj të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës”.</p>	<p>2.The text of the oath is as follows: “I solemnly swear and promise that I will perform faithfully, independently and impartially the duties and functions which are entrusted to me by the Constitution and by Law and will protect and promote human rights and freedoms in the Republic of Kosovo”.</p>	<p>2.Tekst zakletve glasi kao u nastavku:”Ja, zaklinjem se i svečano obećavam da ću na nezavisan i nepristrasan način verno obavljati dužnost i funkcije koje su mi poverene Ustavom i zakonom, da ću štiti i unaprediti ljudska prava i slobode u Republici Kosovo”.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Imuniteti</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Immunity</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Imunitet</p>
<p>1.Avokati i Popullit, zëvendësit e tij dhe personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për fjalët e dhëna apo të shkruara, për veprimtari ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Institucionit të Avokatit të Popullit. Imuniteti funksional vazhdon edhe pas përfundimit të detyrës.</p>	<p>1.Ombudsperson, his/her deputies as well as staff of the Ombudsperson Institution enjoy immunity from prosecution, civil lawsuit and dismissal due to spoken or written statements, for activities or decisions that are within the scope of responsibilities of the Ombudsperson Institution. Functional immunity continues even after accomplishment of the job.</p>	<p>1.Narodni Advokat, njegovi zamenici i osoblje Institucije Narodnog advokata uživaju imunitet od krivičnog gonjenja, građanskih tužbi ili razrešenja za izrečene ili pisane reči, za delatnost ili odluke koje su donete unutar oblasti odgovornosti Institucije Narodnog Advokata. Funkcionalni imunitet nastavlja se i nakon završetka zadatka.</p>
<p>2.Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të pacenueshme. Arkivat, lëndët, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kudo që janë apo nga kushdo që mbahen, janë të pacenueshme dhe gëzojnë imunitet nga kontrolli, marrja, nga kërkimi zyrtar i tyre, nga konfiskimi, nga shpronësimi apo nga çfarëdo ndërhyrje tjetër, qoftë përmes veprimit përmbarues, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.</p>	<p>2.The Offices of the Ombudsperson Institution are inviolable.Archives, subjects, communications, property, funds and assets of the Ombudsperson Institution, wherever they are or by whosoever held, shall be inviolable and enjoy immunity from control, acquisition, official search, confiscation, from expropriation or from any other intervention or through bailiff, administrative, judicial or legislative action.</p>	<p>2.Kancelarije Institucije Narodnog advokata su nepovredljive. Arhiva, predmeti, komuniciranja, svojina, fondovi i imovina Institucije Narodnog dvokata, bilo gde da su Aili od bilo koga da se drže su nepovredljive i uživaju imunitet od kontrole, oduzimanja, od njihovog službenog zahtevanja od konfiskovanja, od izvlaščenja ili bilo kojeg drugog mešanja, bilo preko izvršne, upravne, sudske ili zakonodavne radnje.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 13 Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Dismissal of the Ombudsperson and his/her deputies from their function</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Razrešenje iz funkcije Narodnog Advokata i njegovih/njenih zamenika</p>
<p>1. Avokati i Popullit, dhe zëvendësit e tij/saj mund të shkarkohen për arsyet në vijim:</p> <p>1.1. paaftësia fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij;</p> <p>1.2. ka kryer veprë penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës me gjashtë (6) apo më tepër muaj burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;</p> <p>1.3. nëse kryen veprime në kundërshtim me nën-paragrafin 1.5 të nenit 6 dhe paragrafi 2 të nenit 7 të këtij ligji.</p> <p>2. Procedura për shkarkimin e Avokatit të Popullit duhet të jetë procedurë e hapur dhe publike, ku Avokatit të Popullit i garantohet e drejta të dëgjohet publikisht.</p> <p>3. Avokati i Popullit kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shkarkojë nga detyra një apo më shumë zëvendës të</p>	<p>1. The Ombudsperson and his/her deputies may be dismissed for the following reasons:</p> <p>1.1. due to physical or mental disability that causes inability to perform his/her functions;</p> <p>1.2. in case he/she has committed a criminal offense punishable by the legislation of the Republic of Kosovo to six (6) months imprisonment or more based on court decision of final form;</p> <p>1.3. in case he/she performs actions in contradiction to sub-paragraph 1.5 of Article 6 and paragraph 2 of Article 7 of this Law.</p> <p>2. The procedure for the Ombudsperson's dismissal ought to be open and public and the Ombudsperson is guaranteed to be publically heard.</p> <p>3. Ombudsperson requires from the Assembly of the Republic of Kosovo to dismiss from function one or more of</p>	<p>1. Narodni Advokat i nje gov i zamenici mogu se razrešiti iz sledećih razloga:</p> <p>1.1. fizičke ili mentalne nesposobnost koja onemogućuje obavljanje njegovih funkcija;</p> <p>1.2. ako je počinio krivično delo koje je kažnjivo prema zakonodavstvu Republike Kosovo, sa šest (6) meseci ili više zatvora, na osnovu pravosnažne sudske odluke;</p> <p>1.3. ako vrši radnje u suprotnosti sa podstavom 1.5 člana 6 i stava 2 člana 7 ovog Zakona.</p> <p>Postupak za razrešenje Narodnog advokata treba da bude otvoren i javan, gde se Narodnom advokatu garantuje pravo da bude javno saslušan.</p> <p>3. Narodni Advokat može zatražiti da Skupština Republike Kosovo razreši sa dužnosti jednog ili više njegovih zamenika,</p>

<p>tij/saj, për shkak të një apo më shumë arsyeve të parapara në këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj</p> <p>1.Funksioni i Avokatit të Popullit dhe i zëvendësve të tij/saj mbaron:</p> <p>1.1. me vdekjen e tij;</p> <p>1.2. kur jep dorëheqje;</p> <p>1.3.me përfundim të mandatit të Avokatit të Popullit, respektivisht zëvendësve të tij/saj;</p> <p>1.4. kur shkarkohet.</p> <p>2.Në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, dorëheqjes ose shkarkimit, Avokati i Popullit zëvendësohet nga zëvendësi kryesor apo zëvendësit e tjerë. Në rast të mungesës së zëvendësve, Avokatin e Popullit e zëvendëson zyrtari më i lartë i personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit.</p> <p>3.Në rast të përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit apo zëvendësi i tij/saj do ta ushtroj funksionin e tij deri në</p>	<p>his/her deputies, due to one or more reasons set out in this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 End of the function of the Ombudsperson and his/her deputies</p> <p>1. The function of the Ombudsperson and his/her deputies ends:</p> <p>1.1. in case of death;</p> <p>1.2. in case of resignation;</p> <p>1.3. when the mandate for the Ombudsperson expires, actually expires the mandate of his/her deputies;</p> <p>1.4. when dismissed.</p> <p>2.In case of absence, death, permanent or provisional disability, resignation or dismissal, the Ombudsperson is replaced by the principal deputy or other deputies. In case of their absence the Ombudsperson is replaced by the most senior staff member in the Ombudsperson Institution.</p> <p>3.In case of expiration of the mandate, the Ombudsperson or his/her deputy shall exercise its functions until the election of</p>	<p>iz jednog ili više razloga predvidjenih u ovom zakonu.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Prestanak funkcije Narodnog Advokata i njegovih/njenih zamenika</p> <p>1.Funkcija Narodnog Advokata i njegovih zamenika prestaje:</p> <p>1.1. njegovom smrću;</p> <p>1.2. kada da ostavku;</p> <p>1.3.okončanjem mandata Narodnog Advokata i njegovih/njenih zamenika;</p> <p>1.4. kada se razreši.</p> <p>2.U slučaju izostanka, smrti, trajne ili privremene nesposobnosti, ostavke ili razrešenja, Narodnog advokata zamenjuje njegov glavni zamenik ili drugi zamenici. U slučaju nedostatka zamenika, Narodnog Advokata zamenjuje najviši službenik Institucije Narodnog advokata.</p> <p>3.U slučaju isteka mandata, Narodni Advokat ili njegov/njen zamenik obavićei njegovu funkciju do izbora novog Narodnog</p>
--	---	--

<p>zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit, përkatësisht zëvendësit të ri.</p> <p>4. Avokati i Popullit për zëvendësit e tij/saj të cilët e kanë përfunduar mandatin e parë ka të drejtë t'i propozoj Kuvendit për vazhdimin edhe të një mandati pa procedura të konkurrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Sigurimi i punës pas përfundimit të mandatit</p> <p>1. Pas përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit mund të kthehet në funksionin e tij/saj ose punën publike që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë punëdhënësi i mëhershëm duhet t'i sigurojë një punë të paktën në nivelin e njëjtë, dhe që do të gëzonte pagën e barasvlefshme me atë që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit.</p> <p>2. Avokatit të Popullit, të cilit i përfundon mandati, ose që për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta vazhdojë punën e mëparshme ose nuk mund të gjejë punë tjetër adekuate, e as që i ka plotësuar kushtet e përgjithshme të pensionimit, gëzon të drejtën e pagës në vlerën e pagës së fundit të pranuar, por jo më gjatë se një (1) vit nga përfundimi i mandatit.</p>	<p>the new Ombudsperson, respectively of the new deputy.</p> <p>4. Ombudsperson has the right to propose to the Assembly a term extension, without competitive procedures, for his/her deputies who have completed the first term.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Provision of job after the end of mandate</p> <p>1. After mandate accomplishment of mandate, the Ombudsperson may return to his/her post or public work that he/she had prior to election as Ombudsperson. When this is not possible, then the previous employer must provide a suitable job for him/her at least of the same level with equivalent salary with what he/she had prior to being elected for Ombudsperson.</p> <p>2. When the Ombudsperson, whose mandate expires, cannot continue previous job due to reasonable causes nor find another appropriate job, neither has fulfilled general conditions for retirement, enjoys the right to a remuneration in the amount of the last received salary, but not longer than one (1) year from the end of the mandate.</p>	<p>Advokata, odnosno novog zamenika.</p> <p>4. Narodni Advokat za njegov/njene zamenike koji su završili prvi mandat ima pravo da predloži Skupštini produžetak mandata bez konkursnih procedura.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Obezbeđivanje posla nakon okončanja mandata</p> <p>1. Nakon okončanja mandata, Narodni Advokat može se vartiti na njegovu funkciju ili javnom radu, koju je vršio pre izbora za Narodnog advokata. Kada to nije moguće, onda prethodni poslodavac treba da mu obezbedi jedan prikladan posao najmanje istog nivoa i koji bi primio platu ekvivalentnu onoj koju je imao pre izbora za Narodnog advokata.</p> <p>2. Narodnom Advokatu kojem je okončan mandat, ili zbog opravdanih razoga ne može da obavlja prethodni posao ili ne može da nađe drugi adekvatan posao, a ne ispunjava opšte uslove za penzionisanje, uživa pravo na platu u istoj vrednosti sa poslednjom platom koju je primio, ali ne i duže od jedne (1) godine od okončanja mandata.</p>
--	--	---

KAPITULLI III KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË POPULLIT	CHAPTER III POWERS AND RESPONSIBILITIES OF THE OMBUDSPERSON	POGLAVLJE III NADLEŽNOST I ODGOVORNOSTI NARODNOG ADVOKATA
<p style="text-align: center;">Neni 16 Kompetencat</p> <p>1. Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.</p> <p>2. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Powers</p> <p>1. The Ombudsperson has the power to investigate complaints received from any natural or legal person related to assertions for violation of human rights envisaged by the Constitution, Laws and other acts, as well as international instruments of human rights, particularly the European Convention on Human Rights, including actions or failure to act which present abuse of authority.</p> <p>2. The competences of the Ombudsperson extend to the entire territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. In exercising his/her functions, the Ombudsperson can provide good services to the citizens of the Republic of Kosovo and other persons who live outside the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The Ombudsperson has the power to investigate, either to respond to complaint</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Nadležnosti</p> <p>1. Narodni Advokat ima nadležnost da istražuje primljene žalbe od svakog fizičkog i pravnog lica u vezi tvrdnji o kršenju ljudskih prava predviđenih Ustavom, zakonima i drugim aktima, kao i međunarodnim za ljudska prava, posebno Evropskom konvencijom o ljudskim pravima, obuhvatajući radnje ili neradnje koje predstavljaju zloupotrebu autoriteta.</p> <p>2. Narodni Advokat ima nadležnost da istražuje na celoj teritoriji Republike Kosovo.</p> <p>3. U vršenju svojih funkcija, Narodni Advokat može da pruži dobre usluge svim stanovnicima Republike Kosovo kao i drugim licima koji se nalaze van teritorije Republike Kosova.</p> <p>4. Narodni Advokat ima nadležnost da obavi istragu bilo da bi odgovorio na podnetu</p>

<p>parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.</p> <p>5. Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve.</p> <p>6. Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë apo ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Përrjashtimisht, nëse personi i dëmtuar ka vdekur apo nuk është në gjendje të jap pëlqimin për ndonjë arsye tjetër, ky pëlqim duhet të kërkohet nga të afërmit e ngushtë dhe nëse të afërmit e tillë nuk ekzistojnë apo nuk mund të kontaktohen, pëlqimi nuk është i nevojshëm.</p> <p>7. Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e</p>	<p>filed or on its own initiative (ex officio), if from findings, testimonies and evidence presented by submission or by knowledge gained in any other way, there is a base resulting that the authorities have violated human rights and freedoms stipulated by the Constitution, laws and other acts, as well as international instruments on human rights.</p> <p>5.If the Ombudsperson during the investigation conducted observes the presence of criminal offence, than he/she informs competent body for initiation of investigation.</p> <p>6. If the Ombudsperson starts procedure on his/her own initiative or if any other person on behalf of the damaged person with the submission addresses to the Ombudsperson for initiating of the procedure, the consent from the person whose rights and freedoms have been violated is necessary. Exceptionally, in case the damaged party has died or cannot provide his/ her consent due to any other reason, it should be granted from people most close to him/her and in case none of them exists or contact is impossible, consent is not needed.</p> <p>7.When the Ombudsperson initiates procedure on his own initiative regarding</p>	<p>žalbu ili samoinicijativno (ex officio), ako iz nalaza, dokaza i podnetih činjenica u podnesku ili iz stečenih saznanja na drugi način, ima osnova da proizilazi da su od strane vlasti kršena ljudska prava i slobode, određene Ustavom, zakonima i drugim aktima, kao i međunarodnim instrumentima o ljudskim pravima.</p> <p>5. Ako Narodni Advokat tokom obavljanja istrage uočava da ima elementa krivičnog dela, informiše nadležni organ za početak istrage.</p> <p>6. Ako Narodni Advokat pokrene postupak na sopstvenoj inicijativi ili neko drugo lice na ime oštećenog se obrati podneskom Narodnom advokatu za pokretanje postupka, potrebna je saglasnost lica kojem su kršena ljudska prava i slobode. Izuzetno, ako je oštećena osoba umrla ili nije u stanju da da saglasnost iz nekog drugog razloga, ova saglasnost treba da se traži od bliskih srodnika i. Ako takvi srodnici ne postoje ili ne mogu se kontaktirati, saglasnost nije potrebna.</p> <p>7. Kada Narodni Advokat pokrene postupak na sopstvenoj inicijativi u vezi kršenja prava</p>
---	---	---

<p>të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 6 i këtij neni.</p>	<p>the violation of rights and freedoms to a greater number of citizens, children or persons with lost abilities for action, consent required by paragraph 6 of this Article is not necessary.</p>	<p>i sloboda jednog većeg broja građana, dece ili lica sa izgubljenom poslovnom sposobnošću, nije potrebna saglasnost iz stava 6 ovog člana.</p>
<p>8. Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor.</p>	<p>8. The Ombudsperson may provide general recommendations on the functioning of the judicial system.</p>	<p>8. Narodni Advokat može dati opšte preporuke za funkcionisanje pravosudnog sistema.</p>
<p>9. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave.</p>	<p>9. The Ombudsperson will not intervene in the cases and other legal procedures that are taking place before the courts.</p>	<p>9. Narodni Advokat neće se umešati u slučajevima i drugim pravnim procedurama koja se odvijaju pred sudovima.</p>
<p>10. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.</p>	<p>10. The Ombudsperson may appear in the capacity of the friend of the court (amicus curiae) in judicial processes dealing with human rights, equality and protection from discrimination.</p>	<p>10. Narodni Advokat može da se pojavi u svojstvu prijatelja suda (amicus curiae) u sudskim postupcima vezanim sa ljudskim pravama, pitanjima ravnopravnosti i zaštite od diskriminacije.</p>
<p>11. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.</p>	<p>11. The Ombudsperson may initiate matters to the Constitutional Court in accordance with the Constitution and Law on the Constitutional Court.</p>	<p>11. Narodni Advokat može da inicira pitanja u Ustavni Sud u skladu sa Ustavom i Zakonom o Ustavnom Sudu.</p>
<p>12. Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimi dhe pajtimit.</p>	<p>12. The Ombudsperson shall also exercise his/her competences through mediation and conciliation.</p>	<p>12. Narodni Advokat vrši svoje nadležnosti i preko posredovanja i pomirenja.</p>
<p>13. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.</p>	<p>13. Services offered by the Institution of the Ombudsperson are free of charge.</p>	<p>13. Pružene usluge od strane Institucije Narodnog advokata su bezplatne.</p>

<p>14. Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>15.Mbledh të dhëna statistikore në lidhje me çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe i publikon ato.</p> <p>16.Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.</p> <p>17.Bashkëpunon me partnerët social dhe organizatat jo-qeveritare që merren me çështje të barazisë dhe jo-diskriminimit, si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtare me Avokatin e Popullit.</p>	<p>14. The Ombudsperson performs other work defined by the Law on protection from discrimination, Law on Gender Equality, and other legislation in force.</p> <p>15.Collects statistical data regarding the issues of discrimination and equality presented to the Ombudsperson, and publishes them.</p> <p>16.Publishes reports and makes recommendations on policies and practices on combating discrimination and promoting equality.</p> <p>17.Cooperates with social partners and non-governmental organizations dealing with issues of equality and non-discrimination, as well as similar international bodies like the Ombudsperson.</p>	<p>14.Narodni Advokat vrši i druge poslove utvrđenih Zakonom o zaštiti od diskriminacije i drugim zakonodavstvom na snazi.</p> <p>15.Prikuplja statističke podatke u vezi sa pitanjem diskriminacije i jednakosti, koje su predstavljene u Instituciju Narodnog Advokata, i objavljuje njih.</p> <p>16. Objavljuje izveštaje i daje preporuke o politikama i praksama za borbu protiv diskriminacije, i za promovisanje jednakosti.</p> <p>17.Sarađuje sa socijalnim partnerima i nevladinim organizacijama koje se bave pitanjima ravnopravnosti i nediskriminacije, kao i sa međunarodnim telima, sličnim Narodnom Advokatu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese</p> <p>1. Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: MKP).</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 National Preventive Mechanism of torture and other cruel, inhuman and degrading punishments.</p> <p>1.The Ombudsperson acts as National Preventive Mechanism National Mechanism for the Prevention of torture and other cruel, inhuman and degrading punishments (further in the text NPM).</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Nacionalni mehanizam za sprečavanje torture i protiv drugih okrutnih kazna nečovečnog i ponižavajućeg postupanja</p> <p>1.Narodni Advokat deluje kao nacionalni mehanizam za sprečavanje torture i drugih okrutnih,nečovečnih i ponižavajućih postupanja (u daljem tekstu MKS).</p>

<p>2. Në kuadër të përgjegjësive si MKP, Avokati i Popullit është i obliguar që:</p> <p>2.1.të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria;</p> <p>2.2.në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit të krijojë një mekanizëm të veçantë që do të kryejë të gjitha funksionet e MKP. Personeli i këtij mekanizmi, përveç juristëve duhet të përfshijë profesionistë të fushave të ndryshme, posaçërisht mjekë, psikologë dhe punëtorë social me përvojë në këtë fushë.</p> <p>3. Ekspertët dhe personat e specializuar të angazhuar nga Avokati i Popullit për nevojat e MKP-së, duhet të kenë të drejtat dhe obligimet e njëjta sikurse personeli tjetër i Avokatit të Popullit, përfshirë të drejtën për të vizituar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, për fotografim dhe incizim radio dhe audio vizuele, të gëzojnë mbrojtjen nga ndërhyrja e jashtme në punën e tyre, si dhe të drejtën që të mos japin të dhëna, informata apo sqarime për gjetjet e tyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre në këtë fushë.</p> <p>4.Gjatë kryerjes së funksionit si MKP, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij</p>	<p>2.Within responsibilities as NPM, the Ombudsperson is bound to:</p> <p>2.1. undertake regular and unannounced visits to places of deprivation of liberty;</p> <p>2.2. a specialized branch shall be set up at the Ombudsperson’s Institution that will be tasked with functions of the NPM. The staff of this branch in addition to jurists, shall include a variety of professionals of different fields, including medical doctors, psychologists and social workers with relevant experience and expertise.</p> <p>3. Specialists and experts contracted by the Ombudsperson in respect of its functions as the NPM shall have the same rights and duties as Representatives of the Ombudsperson, including the right to visit places of deprivation of liberty and with the right to take pictures and make sound and video recording, enjoy protection against interference in their activities, as well as the right not to give evidence and explanations on facts that were disclosed to them in the process of exercising their functions.</p> <p>4.When exercising functions of the National Preventive Mechanisms, the Ombudsman</p>	<p>2.U okviru odgovornosti kao NPM, Narodni advokat je obavezan da:</p> <p>2.1. redovno i bez prethodne najave obilazi sva mesta gde borave lica lišena slobode.</p> <p>2.2. u okviru Institucije Narodnog Advokata da formirai jedan poseban mehanizam koji će vršiti sve funkcije Nacionalnog preventivnog mehanizma. Osoblje ovog mehanizma treba da obuhvati stručnjake iz raznih oblasti, posebno lekare sa iskustvom u ovoj oblasti.</p> <p>3.Eksperti i specijalizovana lica angazovani od strane Narodnog Advokata za potrebe Nacionalnog preventivnog mehanizma, treba da imaju ista prava i obaveze kao ostalo osoblje Narodnog Advokata, uključujući pravo da posete mesta gde se drže lica lišena slobode, da fotografišu i urade radio i audio vizuelne zapise, uživaju pravo zaštite od spoljnog mešanja u njihov rad, kao i pravo da ne daju podatke, unformacije ili objašnjenja o njihovim nalazima, tokom vršenja njihovog zadatka u ovoj oblasti.</p> <p>4.Tokom obavljanja funkcije NPM, Narodni Advokat i njegovi predstavnici imaju pravo</p>
---	--	---

<p>kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, pajtimin e tyre, si dhe të dhënat personale të këtyre personave.</p>	<p>and his/her representatives shall have the right to access information about the health status of any person held in places of deprivation of liberty, including access to relevant medical records, as well as, with consent of the person, they shall be entitled to access to his/her personal data.</p>	<p>pristupa u informacije o zdravstvenom stanju lica lišenih slobode, uključujući i pristup u njihova lekarska dosijea, njihovo slaganje, kao i u lične podatke ovih lica.</p>
<p>5.Avokati i Popullit mund të jap rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve, dhe akteve të tjera nënligjore apo administrative, udhëzuesve dhe të praktikave të aplikuara në Kosovë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës.</p>	<p>5.The Ombudsperson can make recommendations on compatibility of laws, and other sub-legal or administrative acts, guidelines and practices of Kosovo in line with the Constitution of Kosovo and international standards as concerns the prevention of torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.</p>	<p>5.Narodni Advokat može davati preporuke o usklađenosti zakona i drugih upravnih akata i prakse primenjene na Kosovu, Ustavom Republike Kosovo i međunarodnim standardima u oblasti prevencije torture, kao i drugih oblika svirepog, nehumanog i ponižavajućeg tretmana i kazni.</p>
<p>6.Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës.</p>	<p>6.The Ombudsperson shall further cooperate with international, regional and other national bodies in charge of prevention of torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.</p>	<p>6.Narodni Advokat treba da saraduje sa međunarodnim i domaćim mehanizmima u oblasti prevencije od torture, kao i drugih oblika svirepog, nehumanog i ponižavajućeg tretmana i kazni.</p>
<p>7.Avokati i Popullit mund të jap sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.</p>	<p>7.The Ombudsperson can make observations and recommendations to those who are in charge of persons deprived of their liberty in all types of facilities and circumstances on how to improve the treatment and conditions of the latter.</p>	<p>7.Narodni Advokat može davati sugestije i preporuke za lica i odgovarajuće institucije gde se drže lica lišena slobode, bez obzira na vrstu ili objekat i okolnosti njihovog držanja, za poboljšanje tretmana i njihovih uslova.</p>

<p align="center">Neni 18 Përgjegjësitë</p>	<p align="center">Article 18 Responsibilities</p>	<p align="center">Član 18 Odgovornosti</p>
<p>1. Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi:</p> <p>1.1. të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre;</p> <p>1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;</p> <p>1.3. të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, si dhe krijimin e një ekipe të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe një programi të përhershëm që fëmijët të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre;</p> <p>1.4. të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes</p>	<p>1. The Ombudsperson has the following responsibilities:</p> <p>1.1. to investigate alleged violations of human rights and acts of discrimination, and be committed to eliminate them;</p> <p>1.2. to draw attention to cases when the institutions violate human rights and to make recommendation to stop such cases and when necessary to express his/her opinion on attitudes and reactions of the relevant institutions relating to such cases;</p> <p>1.3. to draft and adopt specific procedures for receiving and handling complaints from children, and the creation of a specialized team for children's rights and a permanent program for children to become aware of their rights and the role of Ombudsperson institution in their protection;</p> <p>1.4. to inform about human rights and to make efforts to combat all forms of discrimination through increasing of</p>	<p>1. Narodni Advokat ima sledeće odgovornosti:</p> <p>1.1. da istraži navedena kršenja ljudskih prava i diskriminaciju i da se angažuje se za njihovo rešavanje.</p> <p>1.2. da skrene pažnju na slučajeve kada institucije krše ljudska prava i da podnese preporuke da se prekine sa takvim slučajevima, a kada je to neophodno da izrazi svoje mišljenje o stavovima i reagovanju odgovarajućih autoriteta u vezi takvih slučajeva;</p> <p>1.3 da izradi i usvaja posebne procedure za prijem i tretiranje žalbi od dece, kao i stvaranje specijalizovane ekipe za prava deteta i stalnog programa tako da deca postanu svesni svojih prava i uloga institucije Narodnog Advokata, za njihovu zaštitu;</p> <p>1.4. da obelodani ljudska prava i napore ya borbu protiv svih oblika diskriminacije pomoću podizanja svesti,</p>

<p>ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;</p> <p>1.5.të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit;</p> <p>1.6. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;</p> <p>1.7. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.8.të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.9.t'i rekomandojë Kuvendit</p>	<p>awareness, especially through information and education and through the media;</p> <p>1.5. to make recommendations to the Government, the Assembly and other competent institutions of the Republic of Kosovo on matters relating to promotion and protection of human rights and freedoms, equity and non-discrimination;</p> <p>1.6. to publish notifications, opinions, recommendations, proposals and his/her own reports.</p> <p>1.7. to recommend promulgation of new Laws in the Assembly, amendments of the Laws in force and promulgation or amendment of administrative and sub-legal acts by the institutions of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.8. to prepare annual, periodical and other reports on the situation of human rights and freedoms, equality and discrimination and conduct research on the issue of human rights and fundamental freedoms, equality and discrimination in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.9. to recommend to the Assembly the</p>	<p>naroçito preko informisanja i edukacije, a i preko medija;</p> <p>1.5.da preporuçuje Vladu, Skupštinu i druge nadležne institucije Republike Kosovo o pitanjima koje se odnose na unapre]ivanje i zaštitu ljudskih prava i sloboda, ravnopravnosti i nediskriminacije;</p> <p>1.6.da publikuje obaveštenja, mišljenja, preporuke, predloge i svoje izveštaje;</p> <p>1.7.da preporuči donošenje novih zakona u Skupštini, izmene zakona koji su na snazi i donošenje ili izmene podzakonskih i upravnih akata od strane institucija Republike Kosovo;</p> <p>1.8. da pripremi godišnje, periodične i druge izveštaje o stanju osnovnih ljudskih prava i sloboda, ravnopravnosti i diskriminacije i da obavlja istraživanje o pitanjima osnovnih ljudskih prava i sloboda, ravnopravnosti i diskriminacije u Republici Kosovo;</p> <p>1.9. da preporuči Skupštini usklađivanje</p>
---	---	--

<p>harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;</p> <p>1.10.të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;</p> <p>1.11.Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;</p> <p>1.12.obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës;</p> <p>2.Avokati i Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranura ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.</p>	<p>harmonization of legislation with International Standards for Human Rights and Freedoms and their effective implementation;</p> <p>1.10. to cooperate, in accordance with the Constitution and legislation in force, with all organizations, local and international institutions dealing with protection of human rights and freedoms;</p> <p>1.11. The Ombudsperson, his deputies and staff must keep-safe the confidentiality of all information and data they receive, paying special attention to safety of complainants, damaged parties and witnesses, in accordance with the Law on personal data protection;</p> <p>1.12.Obligation for official confidentiality is also valid after ending of mandate or termination of their employment.</p> <p>2.The Ombudsperson can provide advice and give recommendations to any natural or legal person concerning compliance of Laws and sub-legal acts with internationally accepted standards for human rights and freedoms.</p>	<p>zakonodavstva sa medjunarodnim standardima o ljudskim pravima i slobodama kao i njihovu efektivnu primenu;</p> <p>1.10.da sarađuje u skladu sa Ustavom i zakonodavstvom na snazi sa svim domaćim i međunarodnim autoritetima institucijama koji se bave zaštitom ljudskih prava i sloboda;</p> <p>1.11.Narodni Advokat, zamenici i njegovo osoblje treba da čuvaju tajnu svih informacija i podataka koje prime, posvećujući posebnu pažnju bezbednosti žalilaca, oštećenih stranki i svedoka, u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka;</p> <p>1.12.obaveza čuvanja službene tajne važi i nakon okončanja mandata ili radnog odnosa.</p> <p>2.Narodni Advokat može da pruži savete i da preporuke svakom fizičkom i pravnom licu u vezi saglasnosti zakona i drugih podzakonskih akata sa medjunarodnom priznatim standardima o ljudskim pravima i slobodama.</p>
--	---	--

<p>3. Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.</p>	<p>3. The Ombudsperson can advise and recommend to the institutions of the Republic of Kosovo for their programs and policies to ensure the protection and advancement of human rights and freedoms in the Republic of Kosovo.</p>	<p>3. Narodni Advokat može dati svoj savet i preporuke autoritetima Republike Kosovo o programima i njihovim politikama radi obezbeđivanja zaštite i unapređivanja ljudskih prava i sloboda u Republici Kosovo.</p>
<p>4. Avokati i Popullit i ndërmer të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e ankesës së parashtruar sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me nguti.</p>	<p>4. The Ombudsperson undertakes all necessary measures and actions to review complaints submitted under paragraph 1 of Article 16 of this Law, including direct intervention to the competent authorities, who will be required to respond within the time period reasonable as determined by the Ombudsperson. If severe damage continues as a consequence of the complaint under Article 16 paragraph 1 of this Law, the competent authorities are required to respond promptly.</p>	<p>4. Narodni Advokat preuzima sve mere i potrebne radnje radi razmatranja podnetih žalbi prema stavu 1 člana 16 ovog Zakona, obuhvatajući i direktno intervenisanje kod nadležnih autoriteta od kojih će se zahtevati da odgovore u opravdanom vremenu određenom od Narodnog advokata. Ako traje teško oštećenje kao posledica podnete žalbe prema člana 16 stav 1 ovog Zakona, od nadležnih autoriteta zahteva se da brzo odgovore.</p>
<p>5. Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.</p>	<p>5. If during the investigation, the Ombudsperson determines that the execution of an administrative decision may have irreversible consequences for the natural or legal person, he/she can recommend to competent authority to suspend execution of the decision until completion of investigations relating to this issue.</p>	<p>5. Ako tokom istrage, Narodni Advokat konstatuje da izvršenje neke upravne odluke može imati nepopravljive posledice za fizičko ili pravno lice, može dati svoju preporuku da nadležni autoritet obustavi izvršenje navedene odluke do okončanja istrage u vezi tog pitanja od strane Narodnog advokata.</p>
<p>6. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet</p>	<p>6. The Ombudsperson has access to files</p>	<p>6. Narodni Advokat ima pristup u dosijea i</p>

<p>dhe në dokumentet, te çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim me ligj, dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.</p>	<p>and documents of each authority of the Republic of Kosovo, including medical files of the people deprived from liberty, in accordance with the law and review them regarding the cases under its review and according this Law, may require any institution of the Republic of Kosovo and their staff to cooperate with the Ombudsperson, providing relevant information, including full or partial file copy and documents upon request of the Ombudsperson.</p>	<p>dokumenta svakog autoriteta Republike Kosovo, uključujući i lekarska dosijea za lica lišena slobode, u skladu sa zakonom i može iste da razmatra u vezi slučajeva koji su u razmatranju i prema ovom zakonu, može da zahteva od svakog autoriteta Republike Kosovo i njihovog osoblja da saradjuju sa Narodnim Advokatom, obezbeđivši relevantne informacije, obuhvatajući i potpunu ili delimičnu kopiju dosijea i dokumenata prema zahtevu Narodnog advokata.</p>
<p>7.Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.</p>	<p>7. Officials of the Ombudsperson Institution may, at any time and without notice, enter and inspect any place where persons deprived of their liberty are placed and other institutions with limited freedom of movement as well as can be present at meetings or hearing sessions where such persons are involved. Officials of the Ombudsperson Institution may hold meetings with such persons without the presence of officials of respective institution. Any kind of correspondence of these persons with the Ombudsperson Institution is not prevented nor controlled.</p>	<p>7.Zvaničnici institucije Narodnog Advokata, u svako vreme i bez najave, mogu ući i inspektirati svako mesto gde su lica lišena slobode kao i u drugim institucijama sa ograničenom slobodom kretanja i mogu prisusvovati na sastanke ili sednice saslušanja gde su obuhvaćena takva lica. Zvaničnici institucije Narodnog advokata mogu da obave i susrete sa takvim licima bez prisustva zvaničnika odgovarajuće institucije. Svaka vrsta korespondencije ovih lica sa Institucijom Narodnog Advokata se ne ometa ili kontroliše.</p>
<p>8. Avokati i Popullit apo përfaqësuesit e tij mund të hyjnë në hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve.</p>	<p>8.Ombudsperson or his/her representatives can enter the official premises of all authorities.</p>	<p>8.Narodni advokat ili njegovi zastupnici mogu ući u službene prostorije svih autoriteta.</p>

